

SECURITIES EXCHANGES

Bajram Lamaj

Budget Control Department, Tirana, Albania, bajramlamaj@gmail.com

Redon Koleci

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, redon_koleci@hotmail.com

Abstract: It is not easy to specify the moment when the first stock exchange started operating. It has been speculated that the first scholarships were apparently of Italian origin. Around 1400, public debt was traded in Venice and a list was drawn up. Subsequently, the Genoese and Milanese gave a big boost to the exchange fairs. Meanwhile, as early as 1531, in Antwerp (Belgium), the first major stock exchange was born. But the year 1785 had to wait for the Amsterdam Stock Exchange (Netherlands) to be officially organized.

Today, we have arrived at a very large number of scholarships, where among the most important we can mention the National Scholarships, such as that of New York (NYSE), that of Tokyo (TSE), the London Stock Exchange (LSE) etc. These stock exchanges are called national due to the large number of listed companies, the geographical location of these companies, the different clientele of buyers and sellers that use the market, etc.

It can be said that information technology has a direct impact on increasing the activity of the Exchange, the range of services, increasing efficiency and reducing the cost of service as a result of increasing the speed of information processing.

Before we briefly show how the secondary market works, let's get acquainted with a few terms.

A broker is an authorized market participant who trades on his behalf.

A dealer is an authorized market participant who trades on behalf of himself and others.

Developments of the last two decades have broken down the traditional dividing wall between the broker and the dealer. Today the broker can hold a portfolio just as the dealer can perform a brokerage function. The most appropriate term for both participants could be stock exchange intermediaries.

On the Stock Exchange, securities are sold and bought at a certain price called the exchange rate.

In the call market, trading for individual shares is carried out at a certain time. The aim is to gather all the demands and offers and try to reach a single price at which all transactions will be executed and that possibly regulate the market at this time. So the goal is to set a price at which the quantity demanded is as close as possible to the quantity offered.

This type of trading was used in the early stages of stock market development, when there were few listed shares and a small number of investors - trading and is characteristic of small markets with low liquidity.

Keywords: stock exchange, securities exchange, trade

BURSAT E LETRAVE ME VLERË

Bajram Lamaj

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit Tiranë, Shqipëri, bajramlamaj@gmail.com

Redon Koleci

Kolegji „BIZNESI” Prishtinë, Kosovë, redon_koleci@hotmail.com

Abstrakt: Nuk është e lehtë të saktësohet çasti kur filloi të funksionojë bursa e parë e letrave me vlerë. Është hedhur supozimi se bursat e para me sa duket kanë qenë me origjinë italiane. Aty rreth vitit 1400, në Venedik bëhej tregtimi i borxheve publike dhe hartohesh një listë. Në vazhdim, gjenovezët dhe milanezët i dhanë një shtytje të madhe panairëve të këmbimit.

Ndërkohë, që në vitin 1531, në Anverse (Belgjikë), lindi e para burse e madhe e letrave me vlerë. Por, duhej prituri viti 1785 që bursa e Amsterdemit (Hollandë), të ishte e organizuar zyrtarisht.

Sot, kemi mbërritur në një numër shumë të madh bursash, ku ndër më të rëndësishmet mund të përmendim Bursat nacionale, si ajo e Neë Jork-ut (NYSE), atë të Tokios (TSE), Bursen e Londrës (LSE) etj. Këto bursa quhen nacionale për shkak të numrit të madh të kompanive të listuara, shtrirjes gjeografike të këtyre kompanive, klientelës së ndryshme të blerësve dhe shitësve që përdorin tregun etj.

Mund të thuhet që teknologjia e informacionit ka një ndikim direkt në rritjen e aktivitetit të Burses, te games se sherbimeve, ne rritjen e efektivitetit dhe ne uljen e koston se sherbimit si rezultat i rritjes së shpejtësisë së përpunimit të informacionit.

Përpara se të tregojmë shkurtimisht se si funksionon tregu sekondar, le të njihemi me disa terma. Broker quhet një pjesmarrës i autorizuar në treg i cili tregon për llogari të tij. Dealer quhet një pjesmarrës i autorizuar në treg që tregon për llogari të tij dhe të tjerëve. Zhvillimet e dy dekadave të fundit e kanë hedhur poshtë murin ndarës tradicional midis brokerit dhe dealerit. Sot edhe brokeri mund të mbajë portofol ashtu sikurse edhe dealeri mund të kryejë funksion brokerimi. Termi më i përshtatshëm për të dy pjesmarrësit mund të ishte ndërmjetës në bursë. Në Bursë, letrat me vlerë shiten dhe blihen me një çmim të caktuar që quhet kurs. Në tregun e thirrur (call market), tregtimi për aksione individuale kryhet në një kohë të caktuar. Qëllimi është që të mbledhen të gjitha kërkesat dhe ofertat dhe të tentohet të arrihet tek një çmim i vetëm më të cilin do të ekzekutohen të gjithë transaksionet dhe që mundësisht të rregullojë tregun në këtë kohë. Pra qëllimi është që të përcaktohet një çmim me të cilin sasia e kërkuar të jetë sa më e afërt me sasinë e ofruar. Ky lloj tregtimi është përdorur në fazat e para të zhvillimit të bursave, kur kishte pak aksione të kuotuar dhe një numër të vogël investitorësh - tregtare dhe është karakteristike për tregjet e vogla e me likuiditet të ulët.

1. HYRJE

Si rezultat i rritjes së aktivitetit e volumit të tregtimit në vite bursat duhet të rrisnin shpejtesinë e menaxhimit të porositë në mënyrë që të ketë efikasitet dhe ekzekutim të shpejtë. Kështu bursat kanë zhvilluar sisteme të kompjuterizuara duke lejuar në këtë mënyrë që firmat anëtare të transmetojnë urdhrat e vogla direkt tek specialisti pa patur nevojë për ndërhyrjen e brokerit të dyshëmësë. Mund të thuhet që teknologjia e informacionit ka një ndikim direkt në rritjen e aktivitetit të Bursës, të games se shërbimeve, në rritjen e efektivitetit dhe në uljen e kostos së shërbimit si rezultat i rritjes së shpejtësisë së përpunimit të informacionit. (Mund të përmendim këtu që vetëm në një ditë Bursa e Nju Yorkut ka arritur të tregtojë 1 miliardë aksione në ditë). Sot zhvillimi i teknologjisë së informacionit ka bërë që tregjet e vendeve të zhvilluara Europiane të lidhen në një platformë të përbashkët tregtimi. Ndikimi i teknologjisë së informacionit në zhvillimin e Bursës në vite, jepet në materialin për Bursën e Nju Yorkut bashkëngjitur. Karakteristikat dhe organizimi i bursës, bursa e letrave me vlerë është një treg posaçërisht i themeluar dhe i organizuar për të ballafaquar flukset e kërkesave dhe ofertave për letrat me vlerë të pasurive të luajtshme (mobiliare), të emetuara nga shoqëri aksionere, nga shteti dhe nga ente të tjerë publike.

2. BURSË I NJIHEN KËTO FUNKSIONE KRYESORE

Bursat e Letrave me Vlerë - Material Edukues

- Funksioni i rritjes së kapitalit - u jep mundësi kompanive dhe organizmave të tjerë të sigurojnë mjete financiare duke ofruar tituj zyrtarisht të kuptueshëm.
- Funksioni i investimit - u jep mundësi atyre që disponojnë likuiditete të lira, të zgjedhin midis një game të gjerë dhe të seleksionuar titujsh, formën më të përshtatshme të angazhimit të kapitalit të vet.
- Funksioni i likuiditetit - garanton kontraktimin e rregullt të titujve zyrtarisht të kuptueshëm dhe siguron një mobilizim të shpejtë dhe të lehtë.

Bursa në vetvete nuk menaxhon portofol letrash me vlerë pra as blen, as shet, as zotëron dhe as vendos çmime për letrat me vlerë. Ajo që Bursa ofron është tregtimi i këtyre letrave.

3. AVANTAZHET QË OFRON TREGTIMI NË BURSË:

1. Krijimi dhe siguri i një tregu të përhershëm - në të mund të blihet dhe të shitet në çdo kohë një letër me vlerë.
 2. Ekzistenca e Bursës si vend takimi - në të bëhet ballafaqimi i shpejtë për përmbushjen në kohë dhe në sasi të kërkesave dhe ofertave për letra me vlerë.
 3. Transaksionet ekzekutohen me kosto minimale - bursa regjistron të gjitha tregtimet aq shpejt, sa ato bëhen. Rrjeti i kompjuterizuar realizon shfaqjen e numrit të aksioneve të tregtuara dhe çmimin e tyre të tregtimit.
 4. Çmime reale e transparente - çmimet vendosen sipas parimit të kërkesë-ofertës dhe në përputhje me rregullat e tregtimit të bursës.
- Mosekzistenca e Bursës krijon vështirësi dhe pengesa të shumta në procesin e investimit të letrave me vlerë, pasi është shumë e vështirë që blerësi apo shitësi të gjejnë njeri - tjetrin në çdo moment që atyre do t'u lindte e nevojshme.

Një Bursa shërben për dy qëllime: Të krijojë një mekanizëm për Qeveritë dhe kompanitë, për të emëtuar letra me vlerë me qëllim rritjen e kapitalit të tyre - tregu primar.

T'i krijojë investitorëve mundësinë të blejnë dhe të shesin letra me vlerë tashme të emëtuara -tregu sekondar.

4. TREGU PRIMAR

Metodat e emëtimit

Emëtimet e reja të aksioneve janë ndarë në dy kategori:

I. Emetimi primar është emëtimi i aksioneve të reja kur një kompani është pranuar për herë të parë në Bursë.

II. Emetimi sekondar është emëtimi i aksioneve të reja nga një kompani që është e pranuar me parë në Bursë.

Duhet bërë kujdes të mos ngatërrohet termi emëtim primar apo emëtim sekondar me termin treg primar apo treg sekondar.

Përpara se aksionet të emëtohen, kompania emëtuese duhet të përmbushë kërkesat e Bursës për listimin e këtyre letrave. Kompania në fjalë angazhon një bankë investimi, një firmë brokerimi ose firma të tjera letrash me vlerë për të menaxhuar këto emëtime, në emër të tyre.

Metodat e emëtimit variojnë nga tregu në treg, por më të përhapurat janë:

1. Oferta Publike - Aksionet i ofrohen publikut.

2. Vendosja ose Oferta Private (Private placement) - Firmat e letrave me vlerë ose bankat e investimit u shesin aksione vetëm klienteve të tyre.

3. Emetimi në Grup (syndicated issue) - Firmat e letrave me vlerë ose bankat e investimit, organizojnë një grup bankash të cilat marrin një pjesë të emëtimit dhe i'a shesin këto letra me vlerë klientëve të tyre.

Përpara se të tregojmë shkurtimisht se si funksionon tregu sekondar, le të njihemi me disa terma.

Broker quhet një pjesmarrës i autorizuar në treg i cili tregon për llogari të tij.

Dealer quhet një pjesmarrës i autorizuar në treg që tregon për llogari të tij dhe të tjerëve.

Zhvillimet e dy dekadave të fundit e kanë hedhur poshtë murin ndarës tradicional midis brokerit dhe dealerit. Sot edhe brokeri mund të mbajë portofol ashtu sikurse edhe dealeri mund të kryejë funksion brokerimi. Termi më i përshtatshëm për të dy pjesmarrësit mund të ishte ndermjetës në bursë.

Në Bursë, letrat me vlerë shiten dhe blihen me një çmim të caktuar që quhet kurs.

Kurset e letrave me vlerë pësojnë luhatje të shpeshta që vijnë si pasojë e performancës ekonomike dhe planeve të zhvillimit të kompanive të kuotuar në Bursë (si rezultat i ndryshimit të madhësisë së dividendit), të politikës qeveritare, të normës së interesit bankar si dhe nga kërkesa e oferta e tregut për kapitale monetare.

Tregu sekondar, Eksistojnë dy lloj struktura organizimi të tregut sekondar. Këto njihen si tregu i drejtuar nga porosia (order-driven market) dhe tregu i drejtuar nga çmimi (quote-driven market).

Tregu i drejtuar nga porosia

Në një treg të tillë, secili shitës dhe blerës aksionesh ka një broker që vepron për llogari të tij. Psh. roli i brokerit që vepron për një blerës, është të gjejë një shitës me të cilin të realizojë transaksionet e urdhëruara nga klienti.

Kjo lidhje mund të zbatohet në dyshemene e bursës, nëpërmjet një sistemi të kompjuterizuar ose me të dyja së bashku.

Fitimi i brokerit sigurohet nga komisioni që i merret klientit për realizimin e marrveshjes (transaksionit).

Tregu u drejtuar nga çmimi, Në këtë treg gjenden firma të quajtura “market makers” (krijues të tregut). Roli i tyre është të blejnë dhe shesin nën të gjitha kushtet e tregut dhe ata gjithmonë kuotojnë (caktojnë) një çmim për blerje dhe një çmim për shitje.

Dhe në këtë rast, shitësit dhe blerësit kanë ende brokerat që veprojnë në emër të tyre, por në vend që të gjejë palen tjetër, brokeri e rregullon transaksionin me një “market maker”. Edhe në këtë rast, brokeri e siguron fitimin nga komisioni që i merr klientit të tij.

Bursa e Londres (LSE) (deri në 1998) dhe NASDAQ (The National Association of Securities Dealers Automated Quotation), janë tregje të drejtuara nga çmimi.

Rëndësia e Tregut Sekondar, Funksioni më i rëndësishëm i këtij tregu është se u siguron investitorëve, likuiditete.

Tregu primar përfiton shumë nga likuiditeti që prodhon tregu sekondar, pasi investitorët do të hezitonin të blinin letra me vlerë në treg primar n.q.s. nuk do të kishin mundësi t'i shisnin ato në treg sekondar.

Në tregun sekondar behet vleresimi transparent i ecurisë së ndërmarrjeve të kotuara. Luhatjet e çmimeve vijnë jo vetëm nga loja e tregut, por edhe nga shkalla e ecurisë së këtyre kompanive të listuara, pra tregon suksesin ose mosesuksin e aktivitetit të tyre.

Në tregun sekondar, investitorët kanë mundësi të reagojnë ndaj të gjithë informacionit të marrë mbi kompanitë aksionet e të cilave ato duan të blejnë.

Në rast mungese të një tregu sekondar aktiv, emëtuesit potencial të aksioneve ose obligacioneve duhet të paguajnë një normë kthimi më të lartë, me qëllim që të kompensojnë investitorët për riskun e likuiditetit.

Tregjet sekondare janë gjithashtu të rëndësishëm për emëtuesit, pasi çmimi mbizotëruar i letrave me vlerë në treg përcaktohet nga transaksionet në tregun sekondar.

Emëtimet e reja të letrave me vlerë në tregun primar bazohen në çmimet dhe yield-ët e tregut sekondar.

Yield- i është norma e kthimit mbi investimin kapital (principalin).

Organizimi i Bursës së Letrave me Vlerë, Megjithëse bursat janë të ngjashme, ato mund të përdorin sisteme të ndryshme tregtimi ose një kombinim të tyre.

Njëri prej tyre është - tregu ankand i pastër, në të cilin blerësit dhe shitësit e interesuar pranojnë kërkesat dhe ofertat dhe ku urdhërat transmetohen nga një broker që nuk zotëron aksion.

Ky është një sistem price-driven, pasi aksionet i shiten investitorëve me çmim (ofertë) më të lartë dhe blihen nga shitësit me çmim më të ulët.

Sistemi tjetër i tregtimit është - treg dealer, ku dealerat sigurojnë likuiditet duke blerë dhe shitur aksione për vete. Në këtë treg investitorët që kërkojnë të blejnë ose shesin duhet të kontaktojnë me një dealer. Këtu ka një numër dealer-ash që konkurojnë me njëri-tjetrin për të siguruar çmimin më të lartë (të ofruar) kur shitet dhe çmimin më të ulët (të ofruar), kur blihet.

Tregjet gjithashtu mund të ndahen në:

- tregje të thirrur
- tregje të vazhduar

Në tregun e thirrur (call market), tregtimi për aksione individuale kryhet në një kohë të caktuar. Qëllimi është që të mbliidhen të gjitha kërkesat dhe ofertat dhe të tentohet të arrihet tek një çmim i vetëm më të cilin do të ekzekutohen të gjithë transaksionet dhe që mundësisht të rregullojë tregun në këtë kohë. Pra qëllimi është që të përcaktohet një çmim me të cilin sasia e kërkuar të jetë sa më e afërt me sasinë e ofruar.

Ky lloj tregtimi është përdorur në fazat e para të zhvillimit të bursave, kur kishte pak aksione të kuotuar dhe një numër të vogël investitorësh - tregtare dhe është karakteristike për tregjet e vogla e me likuiditet të ulët.

Në tregun e vazhduar (continuous market), tregtimi kryhet në çdo kohë kur tregu është i hapur. Në një treg të tillë, aksionet kuotohen si nga ankandi ashtu dhe nga dealerat.

Nëse është një treg ideal, dealer-i kërkon të blejë ose të shesë për llogari të tij me një çmim të përcaktuar nga kërkesa dhe oferta.

Kur kemi një treg ankandi, supozohet të ketë mjaft shitës dhe blerës që e lejojnë tregun të jetë i vazhduar, që do të thotë se, nëse do të kërkohej të blihen aksione do të gjendet një investitor tjetër i disponueshëm që dëshiron të shesë.

Një kompromis midis një tregu të pastër dealer dhe një tregu të pastër ankandi është një kombinim në të cilin tregu është një treg ankandi, por ekziston një ndërmjetës që vepron si dealer, i cili siguron likuiditete për të bërë të mundur që tregu të jetë po aq likuid sa edhe tregu i vazhduar.

Tregu i vazhduar është karakteristike e bursave të medha perëndimore që karakterizohen nga një treg shumë i thellë dhe nga mungesa e dominimit të pronësisë mbi tituj të veçantë. Një grup institucionesh kontrollojnë një përqindje të vogël të totalit të aksioneve të kompanive të kuotuar në bursë.

Në këto tregje nuk ka mundësi manipulimi, transaksionet realizohen gjatë të gjithë orëve të tregtimit me çmime në varësi të kërkesës dhe ofertës. Këto tregje janë krejtësisht të automatizuar për vetë gjerësinë që i karakterizon dhe kërkesat për shpejtësi ekzekutimi.

5. TREGU I HAPUR ME TË THIRRURA (OPEN-OUTCRY)

Në bursat e mëdha shpesh kemi një kombinim të tregut të vazhduar e plotësisht të automatizuar me sistemin open - outcry.

Urdhërat jepen në dyshemenë e bursës nëpërmjet sistemit open-outcry. Sapo pjesëmarrësit në treg bien dakort për një transaksion, këto të dhëna i jepen operatorëve të bursës që janë të vendosur rreth e rrotull dyshemese së tregimit. Operatorët e bursës më të marrë këto të dhëna i regjistrojnë dhe i përpunojnë në kompjuterin kryesor. Më pas këto të dhëna ekspozohen në tabelat dhe terminalët në hollin e bursës dhe janë të disponueshme në çdo moment nga anëtarët në bursë.

Natyrisht, organizime të tilla bursash, kërkojnë një staf shumë të madh dhe të përgatitur, si dhe shpenzime të medha operative që mund të suportohen vetëm nga këto lloj bursash.

6. RREGULLIMI I BURSAVE

Që një bursë të jetë e sukseshme duhet të operojë brenda një rrjeti rregullues i cili mbahet fort nga pjesëmarrësit e tregut dhe imponohet për zbatim në mënyrë rigoroze nga autoritetet rregulluese.

Organizmat rregullues të Bursave: Komisionet e Letrave me Vlerë ose ente të tjera rregullatore

Është një organizatë vetë-rregulluese që nxjerr rregulla dhe rregullore të cilat rregullojnë aktivitetin e brendshëm të saj dhe i bën ato të detyrueshme për zbatim si nga Bursa dhe nga pjesëmarrësit në treg.

Enti rregullator përkatës ka autoritet legjislativ mbi Bursën, investitorët në të dhe pjesëmarrësit në Bursë. Konkretisht, ai:

- jep licensën për krijimin e Bursave,
- miraton instrumentat që janë objekt te tregtimit në Bursë,

- miraton rregulloret e anëtarësimit, listimit dhe tregtimit në Bursë,
- licenson, kontrollon dhe mbikqyr të gjithë pjesmarrësit në sistemin broker-dealer,
- miraton prospektet në rastin e ofertave publike,
- vendos rregulla dhe kriteret mbi ekspozimin financiar dhe kontabël të kompanive të kuotuar në Bursë.

7. BORDI MBIKQYRES I BURSËS

Është një organ që mbikqyr aktivitetin e Bursës dhe vendos lidhur me ecurinë e saj.

Bordi miraton rregulloret e antarësimit, licensimit, si dhe të gjitha rregulloret që kanë të bëjnë me aktivitetin operacional të Bursës dhe atë të brendshëm të saj.

Gjithashtu miraton edhe procedurat e tregtimit dhe jep miratimin paraprak për të gjitha instrumentat e reja që do të tregtohen në Bursë, sikurse dhe ndryshimet apo modifikimet në tregtimin e atyre ekzistuese.

Aktiviteti i Bursës drejtohet nga Shefi Ekzekutiv (C.E.O) që është dhe anëtar i Bordit Mbikëqyrës (Bordit) të saj.

Fushat e kërkuara të rregullimit përfshijnë:

1. Anëtarësimin në Bursë
2. Listimin në Bursë
3. Strukturën e tregut
4. Sistemin e tregtimit
5. Kuotimin e çmimeve
6. Orët e tregtimit
7. Raportimin e transaksioneve
8. Transparencën e çmimeve
9. Tregtimin nga të brendshmit

Anëtarësimi në Bursë

Ka rregulla strikte lidhur me kompanitë dhe individët që duan të bëhen anëtarë të Bursës. Gjithashtu, duhet të ketë edhe një sistem që të sigurojë nëse janë zbatuar të gjitha rregullat si dhe nëse rregullat nuk janë zbatuar, a janë ndëshkuar shkelësit.

Anëtarët e Bursës në përgjithësi janë pronarët e saj dhe janë pikërisht këta anëtarë që zgjedhin përfaqësuesit e vet në Bordin e Bursës. Qënia anëtar në një bursë do të thotë automatikisht sigurimi i një vendi tregtimi (karrige) në dyshemene e bursës.

Listimi në Bursë, Kërkesat për listim ndryshojnë nga njëra bursë në tjetrën.

Struktura e Tregut, Bursa specifikon si, ku dhe kur duhet bërë tregtimi. Rregullat specifikojnë saktësisht se si duhen lidhur marrvëshjet nëse tregu është order-driven. Në rast se tregu është quote-driven, rregullat specifikojnë të drejtat dhe detyrimet e krijuesve të tregut (market maker). Rregullohet, gjithashtu, dhe dyshmeja e tregtimit ose sistemi i tregtimit të kompjuterizuar.

Kuotimi i Çmimeve, Në një treg quote-driven, kërkesat kryesore janë ato të kuotimit nga ana e krijuesve të tregut të çmimeve sipas kërkesës dhe ofertës nëse brokeri e kërkon me telefon ose nga dyshmeja e bursës.

Çmimet kuotohen gojari, por ato duhet të jenë detyrimisht të shfaqura dhe në ekranin e kompjuterizuar.

Orët e Tregtimit, Rregullat specifikojnë orët e tregtimit në bursë dhe nëse është i lejuar tregtimi jashtë këtyre orëve. Ato variojnë nga njëra bursë në tjetrën.

Raportimi i Transaksioneve, Duhet që për çdo transaksion të ndërmarre, detajet e tij të raportohen në bursë menjëherë. Ky proces varet nga bursa dhe lloji i tregtimit.

Transparenca e Çmimeve, Një treg konsiderohet transparent nëse të gjithë pjesmarrësit e tij mund të shikojnë se çfarë letrave me vlerë janë tregtuar (blerë apo shitur), në çfarë sasive dhe me çfarë çmimi. Në mënyrë që të jetë sa më efektive duhet që detajet e tregtimit të publikohen po aq shpejt sa ato i raportohen bursës. Një vonesë nënkupton që investitorët nuk janë në korent të detajeve të tregtimit.

Tregtimi nga të Brendshmit, Nënkupton tregtimin e letrave me vlerë nga persona të brendshëm të cilët janë në dijeni të informacioneve që nuk janë të njohura publikisht dhe po të bëhen të njohura, kanë ndikim mbi çmimin e këtyre letrave me vlerë. Persona të brendshëm janë ata të cilët kanë akses në informacionet konfidenciale që lidhen me vendimmarrjen mbi aktivitetin operativ dhe strategjik të kompanisë, politikën e dividendëve, të personelit etj (drejtor, president etj).

8. PËRFUNDIM

Bursat e krijuan për lehtësimin e transaksioneve tregtare. Roli i bursave sot nuk është vetëm krijimi i një tregu dhe lehtësive që krijojnë ai, por ai i tërheqjes së kapitaleve, të investimeve në ekonomi dhe kthimi i tyre në investimeve afatgjata.

Kriteret e bursave për pjesmarrjen e publikut në to, kanë qenë tepër strikte, ndërkohë që sot këto kriteret janë

liberalizuar, në mënyrë që dhe publiku i gjerë të mund të hyje në burse më shuma minimale.

Qëllimi i liberalizimit të këtyre kritereve është të sigurojë një bazë të gjerë investitorësh. Institucionet financiare sot kanë marrë një rol primar. Bankat po dalin nga roli i tyre tradicional dhe po marrin një rol investues. Pikërisht e gjithë kjo lojë investimi, zhvillohet në bursë.

Bursat kanë ndihmuar në globalizimin e tregjeve. Investimet bëhen nëpërmjet firmave prestigjioze, që janë të kuotuar në bursë.

Së fundi, mund të themi që Bursat janë një barometër i performancës ekonomike të një vendi.

LITERATURA

Dinçer, H., Yüksel, S., & Adalı, Z. (2019). Economic effects in Islamic stock development of the European countries: Policy recommendations for ethical behaviors. In *Handbook of research on managerial thinking in global business economics* (pp. 58-78). IGI Global.

Kuzheliev, M., Rekunenko, I., Boldova, A., Zhytar, M., & Stabias, S. (2019). Modeling of structural and temporal characteristics in the corporate securities market of Ukraine. *Investment Management & Financial Innovations*, 16(2), 260.

Lahiri, D. (2019). "Major Wall Street players plan exchange to challenge NYSE, Nasdaq". Reuters.

Lemke and Lins, *Soft Dollars and Other Trading Activities*, §2:3 (Thomson West, 2013-2014 ed.)

Mai, P. L. C. (2020). Corruption and stock market development in EAP countries. *Investment Management & Financial Innovations*, 17(2), 266.

McGill, M.R. (2014). Is Asia the next financial center of the world.

Mexmonov, S. (2020). World Experience of Stock Exchange Operations. *Архив научных исследований*, 33(1).

Osipovich, A. (2019). "Wall Street Firms Plan New Exchange to Challenge NYSE, Nasdaq". *The Wall Street Journal*

Ramsay, J. (2018). "Competition among exchanges has reached a new low, and it's dangerous for the stock market"

Stringham, E.P. (2015). *Private Governance: Creating Order in Economic and Social Life*. (Oxford University Press

Stringham, E.P., & Curott, N.A. (2015). *On the Origins of Stock Markets* Oxford University Press